



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1099 Prot.

Tiranë, më 09 / 04 /2026

V E N D I M

Nr. 08, datë 09.04.2026

P Ë R

**MIRATIMIN E RAPORTIT PËR REALIZIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2025 DHE
PROJEKT-BUXHETIN E VITIT 2026**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38, pika 1, gërma h, Statutin e UPT-së, neni 9, pika 3, gërma d, me propozimin e Administratorit të Institucionit, Senati Akademik në mbledhjen e datës 09.04.2026,

VENDOSI:

1. Të miratojë raportin financiar për realizimin e buxhetit të vitit 2025.
2. Të miratojë paraprakisht projekt-buxhetin e hartuar nga Administratori për vitin 2026.
3. T’i propozojë Bordit të Administrimit miratimin e raportit financiar për realizimin e buxhetit të vitit 2025 dhe projekt-buxhetin për vitin 2026 sipas materialit dhe relacionit bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Akli Fundo

